





PËRMBAJTJA

1. INFORMACIONI I SIGURISË.....	3
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË.....	4
3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT.....	6
4. PANELI I KONTROLLIT.....	7
5. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË.....	8
6. PËRZGJEDHJA E PROGRAMIT.....	9
7. CILËSIMET BAZË.....	12
8. PËRDORIMI I PËRDITSHËM.....	15
9. UDHËZIME DHE KËSHILLA.....	17
10. KUJDESI DHE PASTRIMI.....	18
11. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE.....	21
12. FLETA E INFORMACIONIT TË PRODUKTIT.....	24
13. INFORMACIONET TEKNIKE SHITESË.....	25

ME JU NË MENDJE

Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Gjenial dhe elegant, ky produkt është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndjeheni të sigurt se çdo herë do të merrni prej tij rezultate të shkëlqyera.

Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit për:



Merrni këshilla përdorimi, broshura, informacion për ndreqjen e problemeve si dhe për shërbimin:

www.electrolux.com/webselfservice



Regjistroni produktin tuaj për shërbim më të mirë:

www.registerelectrolux.com



Blini aksesore, pjesë konsumi, pjesë këmbimi origjinale për pajisjen tuaj:

www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Përdorni gjithmonë pjesë këmbimi origjinale.

Kur kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme: Modeli, PNC, Numri i serisë.

Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve.

⚠ Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin

📄 Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla

🏠 Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. ⚠ INFORMACIONI I SIGURISË

Përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes, lexoni me kujdes udhëzimet e ofruara. Prodhuesi nuk është përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të papërshtatshëm. Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Fëmijët nga 3 deri në 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara shumë të theksuara dhe komplekse duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbahen nën monitorim të vazhdueshëm.
- Fëmijët nën 3 vjeç duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme.
- Mos i lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Mbajini detergjentet larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.
- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Kjo pajisje është vetëm për përdorim në shtëpi dhe për përdorime të ngjashme, si p.sh.:
 - në shtëpi në fshat, në zonat e kuzhinës për personelin në dyqane, në zyra dhe në ambiente të tjera pune;
 - nga klientët në hotele, motele, hotele me mëngjes dhe ambiente të tjera banimi.
- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.

- Presioni i ujit në punë (minimal dhe maksimal) duhet të jetë mes 0.5 (0.05) / 8 (0.8) bar (MPa)
- Respektoni numrin maksimal të cilësimeve me 13 vende.
- Për të shmangur rreziqet, nëse kabllloja e furnizimit është e dëmtuar, ajo duhet zëvendësuar nga prodhuesi, qendra e autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.
- Vendosini takëmet në koshin e takëmeve me majat e mprehta me drejtim poshtë ose vendosini ato në sirtarin e takëmeve në pozicion horizontal me majat e mprehta poshtë.
- Mos e lini pajisjen me derën të hapur të pamonitoruar për të shmangur shkeljen aksidentale mbi të.
- Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.
- Mos përdorni spërkatës me ujë me presion të lartë dhe/ose avull për të pastruar pajisjen.
- Nëse pajisja ka vrima ajrimi në pjesën e poshtme, ato duhet të mos bllokohen p.sh. nga tapeti.
- Pajisja duhet të lidhet me rrjetin e furnizimit me ujë duke përdorur pajisjet e dhëna të zorrëve. Kompletet e vjetra të tubave nuk duhet të ripërdoren.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi



PARALAJMËRIM!

Vetëm një person i kualifikuar duhet ta instalojë këtë pajisje.

- Hiqni të gjithë paketimin.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Mos e përdorni pajisjen përpara se ta instaloni në strukturën inkaso për arsye sigurie.
- Ndiqni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë.

Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.

- Mos e montoni ose mos e përdorni pajisjen në vende me temperaturë nën 0°C.
- Instaloheni pajisjen në një vend të sigurt dhe të përshtatshëm që plotëson kërkesat e instalimit.

2.2 Lidhja elektrike



PARALAJMËRIM!


Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

- Pajisja duhet tokëzuar.
- Sigurohuni që parametrat në pllakën e specifikimeve të përkojnë me vlerat elektrike të rrjetit elektrik.

- Përdorni gjithmonë një prizë me tokëzim të instaluar mirë.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kablo zgjatuese.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni prizën dhe kabllo elektrike. Nëse kabloja e furnizimit me energji duhet zëvendësuar, kjo duhet bërë nga Qendra jonë e autorizuar e shërbimit.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kabloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllo duke e kapur nga spina.
- Kjo pajisje është e pajisur me një spinë 13 A. Nëse ju duhet ta ndërroni siguresën e spinës, përdorni vetëm një siguresë 13 A ASTA (BS 1362) (vetëm Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda).

2.3 Lidhja e ujit

- Mos u shkaktoni dëmtim tubave të ujit.
- Përpara lidhjes me tuba të rinj, tubat që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë, aty ku janë kryer punime riparimi ose janë vendosur pajisje të reja (sahate uji, etj.), lëreni ujin të rrjedhë derisa të jetë i kthjellët dhe i pastër.
- Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje të dukshme uji gjatë dhe pas përdorimit të parë të pajisjes.
- Zorra e hyrjes së ujit ka një valvul sigurie dhe një veshje me kablo të brendshme.



PARALAJMËRIM!

Tension i rrezikshëm.

- Nëse zorra e hyrjes së ujit dëmtohet, mbyllni menjëherë rubinetin e ujit dhe shkëputni spinën nga priza elektrike. Kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për zëvendësimin e tubit të hyrjes së ujit.

2.4 Përdorimi

- Mos vendosni produkte të ndezshme ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë ose mbi pajisje.
- Detergjentet e lavastoviljeve janë të rrezikshme. Zbatoni udhëzimet e sigurisë në ambalazhin e detergjentit.
- Mos pini ujin në pajisje dhe mos luani me të.
- Mos i hiqni enët nga pajisja derisa të ketë përfunduar programi. Mbi enë mund të mbesë detergjent.
- Mos u ulni dhe mos peshoni mbi derën e hapur të pajisjes.
- Pajisja mund të lëshojë avull të nxehtë kur hapni derën gjatë kohës që një program larjeje është në punë.

2.5 Shërbimi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me qendrën të autorizuar të shërbimit.
- Përdorni vetëm pjesë këmbimi origjinale.

2.6 Eliminimi i pajisjes




PARALAJMËRIM!

Rrezik lëndimi ose mbytjeje.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit elektrik.
- Prisni kabllo e lidhjes me rrjetin dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar bllokimin brenda pajisjes të fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake.

3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT



- 1** Krah u spërkatës i sipërm
- 2** Krah u spërkatës i poshtëm
- 3** Filtrat
- 4** Etiketa e specifikimeve
- 5** Kutia e kripës
- 6** Tubi i ajrit

- 7** Foleja e shkëlqyesit
- 8** Foleja e detergjentit
- 9** Koshi i takëmeve
- 10** Koshi i poshtëm
- 11** Koshi i sipërm

3.1 Beam-on-Floor


Beam-on-Floor është një dritë që shfaqet në dysheme poshtë derës së pajisjes.

- Kur programi fillon punën, ndizet drita e kuqe dhe ajo qëndron e ndezur për kohëzgjatjen e programit.
- Kur programi përfundon, ndizet një dritë e gjelbër.
- Kur pajisja ka një keqfunksionim, drita e kuqe pulson.

i Beam-on-Floor fuket kur pajisja çaktivizohet.


i Kur AirDry është aktivizuar gjatë fazës së tharjes, projektimi në dysheme mund të mos jetë krejtësisht i dukshëm. Për të parë nëse cikli ka përfunduar, kontrolloni panelin e kontrollit.

4. PANELI I KONTROLLIT



- | | |
|---|----------------------------|
| 1 Butoni i ndezjes/fikjes | 5 EXTRAS butonat |
| 2 Delay Start butoni | 6 AUTO Sense butoni |
| 3 Ekran | |
| 4 MY TIME shiriti i përzgjedhjes | |

4.1 Ekran



- A.** ECOMETER
B. Treguesit
C. Treguesi i kohës

4.2 ECOMETER



ECOMETER tregon se si përzgjedhja e programit ndikon te konsumi i energjisë dhe ujit. Sa më shumë shiritat të ketë të aktivizuar, aq më i ulët është konsumi.

ECO tregon përzgjedhjen e programit më miqësor për ambientin për një ngarkesë me ndotje normale.

4.3 Treguesit

Treguesi	Përshkrimi
	Treguesi i shkëlqyesit. Ndizet kur kutia e shkëlqyesit ka nevojë për rimbushje. Referojuni kapitullit “Përpara përdorimit të parë” .
	Treguesi i kripës. Ndizet kur kutia e kripës ka nevojë për rimbushje. Referojuni kapitullit “Përpara përdorimit të parë” .
	Machine Care treguesi. Është i ndezur kur pajisja ka nevojë për pastrim të brendshëm me programin Machine Care. Referojuni kapitullit “Kujdesi dhe pastrimi” .
	Treguesi i fazës së tharjes. Ndizet kur zgjidhet një program me fazën e tharjes. Pulson kur është në funksionim faza e tharjes. Referojuni kapitullit “Përzgjedhja e programit” .

5. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

1. Sigurohuni që niveli aktual i zbutësit të ujit të përkojë me fortësinë e ujit në zonën që furnizohet. Nëse jo, përshtatni nivelin e zbutësit të ujit.
2. Mbushni kutinë e kripës.
3. Mbushni shpërndarësin e shkëlqyesit.
4. Hapeni rubinetin e ujit.
5. Nisni programin Quick për të hequr çdo mbetje nga procesi i prodhimit. Mos përdorni detergjent dhe mos vendosni enë në kosh.

Pasi nisni një program, pajisja rimbush solucionin në zbutësin e ujit për deri në 5 minuta. Faza e larjes fillon vetëm pasi kjo procedurë të ketë përfunduar. Procedura përsëritet në mënyrë periodike.

5.1 Kutia e kripës




KUJDES!

Përdorni kripë të ashpër që është vetëm për lavastovilje. Kripa e imët rrit rrezikun e ndryshkut.


Kripa përdoret për të ringarkuar solucionin në zbutësin e ujit dhe për të garantuar rezultate të mira larjeje në përdorimin e përditshëm.

Mbushja e kutisë së kripës

1. Rrotullojeni kapakun e kutisë së kripës në drejtim të kundërt të akrepave të orës dhe hiqeni.
2. Vendosni 1 litër ujë në kutinë e kripës (vetëm herën e parë).
3. Mbusheni kutinë e kripës me 1 kg kripë (derisa të mbushet plot).



4. Tundeni hinkën me kujdes nga doreza që të futen brenda edhe kokrrizat e fundit.
5. Hiqni kripën përreth vrimës së kutisë së kripës.




6. Rrotulloni kapakun e kutisë së kripës në drejtim të akrepave të orës për ta mbyllur kutinë e kripës.



KUJDES!

Uji dhe kripa mund të derdhen nga kutia e kripës kur e mbushni. Pasi ta mbushni kutinë e kripës, nisni menjëherë një program larjeje për të shmangur gërryerjen.

5.2 Mbushja e kutisë së shpëlarësit



KUJDES!

Përdorni vetëm shpëlarës të posaçëm për lavastovilje.

1. Shtypni butonin e lëshimit (D) për të hapur kapakun (C).
2. Hidhni shpëlarësin në kutinë e shpëlarësit (A) derisa lëngu të arrijë nivelin "max" të mbushjes.

3. Hiqni shpëlarësin e derdhur me një leckë thithëse për të parandaluar formimin e shkumës së tepërt.
4. Mbyllni kapakun. Siguroni që butoni i lëshimit të ngecë në vend.




Mund ta rrotulloni zgjedhësin e sasisë së lëshuar **(B)** midis pozicionit 1 (sasia më e ulët) dhe pozicionit 4 ose 6 (sasia më e lartë).

6. PËRZGJEDHJA E PROGRAMIT

6.1 MY TIME

Duke përdorur shiritin e përzgjedhjes MY TIME, ju mund të zgjidhni një cikël të përshtatshëm larjeje bazuar në kohëzgjatjen e programit, që varion nga 30 minuta në katër orë.



- A. • **Quick** është programi më i shkurtër (**30min**) i përshtatshëm për një ngarkesë me ndotje të sapobërë dhe të lehtë.
- **Shpëlarje paraprake (15min)** është program për shpëlarjen e mbetjeve ushqimore nga pjatat. Parandalon formimin e aromave në pajisje. Mos përdorni detergjent me këtë program.
- B. **1h** është programi i përshtatshëm për një ngarkesë me ndotje të lehtë të tharë.
- C. **1h 30min** është program i përshtatshëm për larjen dhe tharjen e artikujve me ndotje normale.
- D. **2h 40min** është program i përshtatshëm për larjen dhe tharjen e artikujve me ndotje të fortë.
- E. **ECO** është programi më i gjatë (**4h**) që ofron përdorimin më efikas të

konsumit të ujit dhe të energjisë për takëme dhe enë prej fajance me ndotje normale. Ky është programi standard për institutet e testimit.

6.2 EXTRAS

Ju mund të rregulloni përzgjedhjen e programit sipas nevojave tuaja duke aktivizuar EXTRAS.

ExtraPower

ExtraPower përmirëson rezultatet e larjes së programit të zgjedhur. Opsioni rrit temperaturën dhe kohëzgjatjen e larjes.

GlassCare

GlassCare ofron kujdes të veçantë për një ngarkesë delikate. Opsioni parandalon ndryshimet e shpejta në temperaturën e larjes së programit të zgjedhur dhe e redukton në 45 °C. Kjo mbron qelqurit në veçanti nga dëmtimi.

6.3 AUTO Sense

Programi AUTO Sense përshtat automatikisht ciklin e larjes me llojin e ngarkesës.

Pajisja e dallon nivelin e ndotjes dhe sasinë e enëve në kosha. Ajo e rregullon temperaturën dhe sasinë e ujit, si edhe kohëzgjatjen e larjes.

6.4 Vështrim i përgjithshëm i programeve

Programi	Lloji i ngarkesës	Niveli i ndotjes	Fazat e programit	EXTRAS
Quick	- Enë prej fajance - Takëmet	E sapobërë	- Larje 50 °C - Shpëlarja e ndërmjetme - Shpëlarja përfundimtare 45 °C - AirDry	- ExtraPower - GlassCare
 Shpëlarje paraprake	Të gjitha llojet e ngarkesave	Të gjitha shkallët e ndotjes	Paralarje	EXTRAS nuk janë të aplikueshme për këtë program.
1h	- Enë prej fajance - Takëmet	- E sapobërë - E tharë e lehtë	- Larje 60 °C - Shpëlarja e ndërmjetme - Shpëlarja përfundimtare 50 °C - AirDry	- ExtraPower - GlassCare
1h 30min	- Enë prej fajance - Takëmet - Tenxhere - Tiganë	- Normale - E tharë e lehtë	- Larje 60 °C - Shpëlarja e ndërmjetme - Shpëlarja përfundimtare 55 °C - Tharje - AirDry	- ExtraPower - GlassCare
2h 40min	- Enë prej fajance - Takëmet - Tenxhere - Tiganë	- Normale deri e rëndë - E tharë	- Paralarje - Larje 60 °C - Shpëlarja e ndërmjetme - Shpëlarja përfundimtare 60 °C - Tharje - AirDry	- ExtraPower - GlassCare
ECO	- Enë prej fajance - Takëmet - Tenxhere - Tiganë	- Normale - E tharë e lehtë	- Paralarje - Larje 50 °C - Shpëlarja e ndërmjetme - Shpëlarja përfundimtare 55 °C - Tharje - AirDry	- ExtraPower - GlassCare

Programi	Lloji i ngarkesës	Niveli i ndotjes	Fazat e programit	EXTRAS
AUTO Sense	- Enë prej fajance - Takëmet - Tenxhere - Tiganë	Programi përshtatet për të gjitha shkallët e ndotjes.	- Paralarje - Larje 50 - 60 °C - Shpëlarja e ndërmjetme - Shpëlarja përfundimtare 60 °C - Tharje - AirDry	EXTRAS nuk janë të aplikueshme për këtë program.
Machine Care	Pa ngarkesë	Programi pastron brendësinë e pajisjes.	- Larje 70 °C - Shpëlarja e ndërmjetme - Shpëlarja përfundimtare - AirDry	EXTRAS nuk janë të aplikueshme për këtë program.

Vlerat e konsumit

Programi 1)	Uji (litra)	Energjia (kWh)	Kohëzgjatja (minuta)
Quick	9.4 - 11.4	0.57 - 0.69	30
Shpëlarje paraprake	3.7 - 4.5	0.02 - 0.05	15
1h	9.3 - 11.4	0.82 - 0.94	60
1h 30min	9.1 - 11.1	1.01 - 1.13	90
2h 40min	9.2 - 11.2	0.96 - 1.08	160
ECO	9.9	0.821	240
AUTO Sense	8.2 - 11.2	0.67 - 1.08	120 - 170
Machine Care	8.4 - 10.2	0.60 - 0.71	60

1) Presioni dhe temperatura e ujit, ndryshimet në furnizimin me energji elektrike, opsionet dhe sasia e enëve mund t'i ndryshojnë vlerat.

Informacion për institutet e testimit

Për të marrë informacionin e nevojshëm për kryerjen e testeve (p.sh. sipas EN60436), dërgoni një email në adresën:

info.test@dishwasher-production.com

Në kërkesën tuaj ju lutemi përfshini kodin e numrit të produktit (PNC) që gjendet në pllakëzën e parametrave.

Për pyetje të tjera në lidhje me lavastoviljen tuaj, ju lutemi referojuni librit të shërbimit që keni marrë me pajisjen.

7. CILËSIMET BAZË

Ju mund të konfiguroni pajisjen duke ndryshuar cilësimet bazë sipas nevojave tuaja.


Numri	Cilësimet	Vlerat	Përshkrim ¹⁾
1	Fortësia e ujit	Nga niveli 1L në nivelin 10L (vlera e parazgjedhur: 5L)	Rregulloni nivelin e zbutësit të ujit sipas fortësisë së ujit në zonën tuaj.
2	Njoftimi i zbrazjes së kutisë së shkëlqyesit	On (vlera e parazgjedhur) Off	Aktivizoni ose çaktivizoni treguesin e shkëlqyesit.
3	Tingulli i përfundimit	On Off (vlera e parazgjedhur)	Aktivizoni ose çaktivizoni sinjalin akustik për përfundimin e një programi.
4	Hapja automatike e derës	On (vlera e parazgjedhur) Off	Aktivizoni ose çaktivizoni AirDry.
5	Tingujt e tasteve	On (vlera e parazgjedhur) Off	Aktivizoni ose çaktivizoni tingujt e butonave kur shtypen.
6	Programi i fundit i zgjedhur	On Off (vlera e parazgjedhur)	Aktivizoni ose çaktivizoni përzgjedhjen automatike për programet dhe opsionet e zgjedhura së fundi.

1) Për më shumë detaje, referojuni informacionit që ofrohet në këtë kapitull.

Mund të ndryshoni cilësimet bazë në regjimin e cilësimeve.

Kur pajisja është në regjimin e cilësimeve, shiritat e ECOMETER përfaqësojnë cilësimet e disponueshme. Për secilin cilësim, pulson një shirit i dedikuar i ECOMETER.

Sipas rendit të cilësimeve bazë të prezantuara në tabelë është gjithashtu edhe rendi i cilësimeve në ECOMETER:



7.1 Zbutësi i ujit

Zbutësi i ujit heq mineralet nga uji, gjë që mund të ketë një efekt negativ në rezultatet e larjes dhe në pajisje.

Sa më e lartë të jetë përmbajtja e këtyre mineraleve, aq më i fortë është uji. Fortësia e ujit matet në shkallët ekuivalente.

Zbutësi i ujit duhet të rregullohet sipas fortësisë së ujit në zonën tuaj. Autoritetet përkatëse të ujësjellësit mund t'ju informojnë mbi fortësinë e ujit në zonën tuaj. Është e rëndësishme që të vendosni nivelin e duhur të zbutësit të ujit për të siguruar rezultate të mira në larje.



Zbutja e ujit të fortë rrit konsumin e ujit dhe të energjisë si edhe në kohëzgjatjen e programit. Sa më i lartë niveli i zbutësit të ujit, aq më i lartë konsumi dhe aq më e gjatë kohëzgjatja.

Fortësia e ujit

Gradë gjermane (°dH)	Gradë franceze (°fH)	mmol / l	Gradë Clarke	Niveli i zbutësit të ujit
47 - 50	84 - 90	8,4 - 9,0	58 - 63	10
43 - 46	76 - 83	7,6 - 8,3	53 - 57	9
37 - 42	65 - 75	6,5 - 7,5	46 - 52	8
29 - 36	51 - 64	5,1 - 6,4	36 - 45	7
23 - 28	40 - 50	4,0 - 5,0	28 - 35	6
19 - 22	33 - 39	3,3 - 3,9	23 - 27	5 1)
15 - 18	26 - 32	2,6 - 3,2	18 - 22	4
11 - 14	19 - 25	1,9 - 2,5	13 - 17	3
4 - 10	7 - 18	0,7 - 1,8	5 - 12	2
<4	<7	<0,7	< 5	1 2)

1) Cilësimi i paracaktuar në fabrikë.

2) Mos përdorni kripë në këtë nivel.

Pavarësisht llojit të detergjentit të përdorur, vendosni nivelin e duhur të fortësisë së ujit për të mbajtur aktiv treguesin e rimbushjes me kripë.



Tabletat e shumëfishta që përmbajnë kripë nuk janë mjaft efikase për të zbutur ujin e fortë.

7.2 Njoftimi i zbrazjes së kutisë së shpëlarësit

Shpëlarësi ndihmon në tharjen e enëve pa shenja dhe njolla. Ai lëshohet automatikisht gjatë fazës së shpëlarjes me ujë të nxehtë.

Kur kutia e shpëlarësit zbrazet, treguesi i shpëlarësit aktivizohet duke njoftuar për

rimbushjen me shpëlarës. Nëse rezultatet e tharjes janë të kënaqshme gjatë kohës që përdorni vetëm tableta të kombinuara, mund ta çaktivizoni njoftimin për rimbushjen e shpëlarësit. Megjithatë, për performancën më të mirë në tharje, gjithmonë përdorni shpëlarës.

Nëse përdoret detergjent standard ose tableta të kombinuara pa shpëlarës, aktivizoni njoftimin për të mbajtur aktiv treguesin e rimbushjes me shpëlarës.

7.3 Tingulli i përfundimit


Mund të aktivizoni një sinjal akustik që bie kur përfundon programi.



Sinjalet akustike bien edhe kur ka një keqfunksionim të pajisjes. Këto sinjale nuk mund të çaktivizohen.

7.4 AirDry

AirDry Përmirëson rezultatet e tharjes. Dera e pajisjes hapet automatikisht gjatë fazës së tharjes dhe mbetet paksa e hapur.



AirDry aktivizohet automatikisht me të gjitha programet përveç Shpëlarje paraprake.



KUJDES!

Mos u përpiqni të mbyllni derën e pajisjes brenda 2 minutave pas hapjes automatike. Kjo mund të shkaktojë dëmtim të pajisjes.



KUJDES!

Nëse fëmijët kanë akses te pajisja, këshillojmë të çaktivizoni AirDry. Hapja automatike e derës mund të paraqesë rrezik.



Kur AirDry hap derën, Beam-on-Floor mund të mos jetë krejtësisht e dukshme. Për të parë nëse programi ka përfunduar, shikoni panelin e kontrollit.

7.5 Tingujt e tasteve

Butonat në panelin e kontrollit bëjnë një tingull kërcitës kur i shtypni. Këtë tingull mund ta çaktivizoni.

7.6 Programi i fundit i zgjedhur

Ju mund të caktoni përzgjedhjen automatike për programet dhe opsionet e zgjedhura së fundi.


Ruhet programi më i fundit që ka përfunduar përpara çaktivizimit të pajisjes. Më pas ruhet automatikisht pasi aktivizoni pajisjen.

Kur çaktivizohet përzgjedhja e programit më të fundit, programi i parazgjedhur është ECO.

7.7 Regjimi i cilësimit

Navigimi te regjimi i cilësimit

Ju mund të navigoni te regjimi i cilësimit duke përdorur shiritin e përzgjedhjes MY TIME.



A. E mëparshme butoni

B. OK butoni

C. Tjetër butoni

Përdorni **E mëparshme** dhe **Tjetër** për të kaluar mes cilësimeve bazë dhe për të ndryshuar vlerën e tyre.

Përdorni **OK** për të hyrë te cilësimi i zgjedhur dhe për të konfirmuar ndryshimin e vlerës së tij.

Mënyra e hyrjes në regjimin e cilësimit

Ju mund të hyni në regjimin e cilësimit përpara se të nisni një program. Ju nuk mund të hyni në regjimin e cilësimit ndërsa programi është në punë.

Për të hyrë në regjimin e cilësimit, shtypni dhe mbani shtypur njëkohësisht

Quick dhe **ECO** për rreth 3 sekonda. Ndizen dritat që lidhen me **E mëparshme**, **OK** dhe **Tjetër**.

Ndryshimi i një cilësimi

Sigurohuni që pajisja të jetë në regjimin e cilësimit.

1. Përdorni **E mëparshme** ose **Tjetër** për të zgjedhur shiritin e ECOMETER të dedikuar në cilësimin e dëshiruar.
 - Shiriti i ECOMETER të dedikuar për cilësimin e zgjedhur pulson.
 - Në ekran shfaqet vlera e cilësimit aktual.
2. Shtypni **OK** për të futur cilësimin.
 - Shiriti i ECOMETER të dedikuar për cilësimin e zgjedhur ndizet. Shiritat e tjerë fiken.
 - Vlera e cilësimit përkatës pulson.

3. Shtypni **E mëparshme** ose **Tjetër** për të ndryshuar vlerën.
4. Shtypni **OK** për të konfirmuar cilësimin.
 - Cilësimi i ri ruhet.
 - Pajisja kthehet te lista e cilësimeve bazë.
5. Shtypni dhe mbani shtypur njëkohësisht Quick dhe **ECO** për rreth 3 sekonda për të dalë nga regjimi i cilësimit.


Pajisja kthehet sërish në përzgjedhjen e programit.

Cilësimet e ruajtura mbeten të vlefshme derisa t'i ndryshoni sërish.

8. PËRDORIMI I PËRDTITSHËM

1. Hapeni rubinetin e ujit.
2. Shtypni dhe mbani shtypur ① derisa pajisja të aktivizohet.
3. Mbusheni kutinë e kripës nëse është bosh.
4. Mbushni folenë e shkëlqyesit nëse është bosh.
5. Mbushni koshat.
6. Shtoni detergjentin.
7. Përzgjedhja dhe fillimi i një programi.
8. Mbyllni rubinetin e ujit kur programi të përfundojë.

8.1 Përdorimi i detergjentit



1. Shtypni butonin e lëshimit (**B**) për të hapur kapakun (**C**).
2. Futni detergjentin pluhur ose në tableta në dhomëz (**A**).
3. Nëse programi ka fazë paralarjeje, vendosni një sasi të vogël detergjenti

në pjesën e brendshme të derës së pajisjes.

4. Mbyllni kapakun. Siguroni që butoni i lëshimit të ngecë në vend.

8.2 Zgjedhja dhe përdorimi i një programi duke përdorur shiritin e përzgjedhjes MY TIME

1. Rrëshqitni gishtin nëpër shiritin e përzgjedhjes MY TIME për të zgjedhur një program të përshtatshëm.
 - Drita e lidhur me programin e zgjedhur ndizet.
 - ECOMETER tregon nivelin e energjisë dhe konsumit të ujit.
 - Ekran tregon kohëzgjatjen e programit.
2. Aktivizoni EXTRAS të aplikueshme nëse dëshironi.
3. Mbyllni derën e pajisjes për të filluar programin.

8.3 Përzgjedhja dhe nisja e programit Shpëlarje paraprake

1. Për të zgjedhur  Shpëlarje paraprake, shtypni dhe mbani shtypur Quick për 3 sekonda.

- Drita e lidhur me butonin është e ndezur.
 - ECOMETER është e fikur.
 - Ekran tregon kohëzgjatjen e programit.
2. Mbyllni derën e pajisjes për të filluar programin.

8.4 Si ta aktivizoni EXTRAS

1. Zgjidhni një program duke përdorur shiritin e përzgjedhjes MY TIME.
2. Shtypni butonin e dedikuar me opsionin që dëshironi të aktivizoni.
 - Drita e lidhur me butonin ndizet.
 - Ekran tregon kohëzgjatjen e përditësuar të programit.
 - ECOMETER tregon nivelin e përditësuar të energjisë dhe konsumit të ujit.

i Si parazgjedhje, opsionet mund të aktivizohen kurdo përpara nisjes së një programi. Nëse aktivizohet përzgjedhja e programit të fundit, opsionet e ruajtura aktivizohen bashkë me programin.

i Nuk mund t'i aktivizoni ose çaktivizoni opsionet gjatë kryerjes së një programi.

i Jo të gjitha opsionet përputhen me njëra-tjetrën.

i Çaktivizimi i opsioneve shpesh mund të rrisë konsumin e ujit dhe të energjisë si edhe në kohëzgjatjen e programit.

8.5 Nisja e programit AUTO Sense

1. Shtypni **AUTO Sense**.
 - Drita e lidhur me butonin ndizet.
 - Ekran tregon kohëzgjatjen më të gjatë të mundshme të programit.

i MY TIME dhe EXTRAS nuk janë të aplikueshme për këtë program.

2. Mbyllni derën e pajisjes për të filluar programin.

Pajisja dallon llojin e ngarkesës dhe rregullon një cikël të përshtatshëm larjeje. Gjatë ciklit, sensorët punojnë disa herë dhe mund të rritet kohëzgjatja fillestare e programit.

8.6 Si të shtyni fillimin e programit

1. Zgjidhni një program.
2. Shtypni  në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të tregojë kohën e dëshiruar të vonesës (nga 1 në 24 orë).

Drita e lidhur me butonin ndizet.

3. Mbyllni derën e pajisjes për të filluar numërimin mbrapsht.

Gjatë numërimit mbrapsht, nuk mund të ndryshohet koha e shtyrjes së programit dhe përzgjedhja e programit.

Programi fillon kur përfundon numërimi mbrapsht.

8.7 Anulimi i shtyrjes së nisjes së programit ndërsa funksionon numërimi mbrapsht

Shtypni dhe mbani shtypur  për 3 sekonda.

Pajisja kthehet sërish në përzgjedhjen e programit.

i Nëse e anuloni shtyrjen e nisjes së programit, duhet ta zgjidhni programin përsëri.

8.8 Anulimi i një programi në funksionim

Shtypni dhe mbani shtypur  për 3 sekonda.

Pajisja kthehet sërish në përzgjedhjen e programit.

i Sigurohuni që të ketë detergjent në follenë e detergjentit përpara se të filloni një program të ri.

8.9 Hapja e derës ndërkohë që pajisja është në punë

Hapja e derës ndërkohë që programi është në punë, ndalon pajisjen. Kjo mund të ndikojë në konsumin e energjisë dhe kohëzgjatjen e programit. Pasi e mbyllni derën, pajisja vazhdon nga pika ku u ndërpre.



Nëse dera mbahet hapur për më shumë se 30 sekonda gjatë fazës së tharjes, programi që është në punë do të përfundojë. Kjo nuk ndodh nëse dera hapet me funksionin AirDry.

8.10 Funksioni Auto Off

Ky funksion ruan energjinë duke e fikur pajisjen kur nuk është në punë.

Funksioni nis të funksionojë automatikisht:

- Kur programi ka përfunduar.
- Pas 5 minutave, nëse programi nuk ka filluar.

8.11 Përfundimi i programit

Kur programi të ketë përfunduar, ekrani tregon 0:00.

Funksioni Auto Off e fik automatikisht pajisjen.

Të gjithë butonat janë joaktivë, përveç butonit të ndezjes/fikjes.

9. UDHËZIME DHE KËSHILLA

9.1 Të përgjithshme

Ndiqui këshillat e mëposhtme për të garantuar rezultate optimale pastrimi dhe tharjeje në përdorimin ditor dhe për t'ju ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit.

- Hidhni në koshin e mbeturinave mbetjet e mëdha të ushqimeve në enë.
- Mos i shpëlani enët paraprakisht me dorë. Kur t'ju nevojitet, vendosni një program me fazë paralarjeje.
- Përdoreni gjithmonë të gjithë hapësirën e koshave.
- Sigurohuni që artikujt në kosha të mos prekin ose të mos mbulojnë njeri-tjetrin. Vetëm atëherë uji mund të arrijë dhe të lajë plotësisht enët.
- Mund të përdorni detergjent për larjen e enëve, shpëlarës dhe kripë veçmas ose mund të përdorni tabletat e shumëfishta (p.sh. "Të gjitha në 1"). Ndiqui udhëzimet e shfaqura në paketim.
- Zgjidhni një program sipas llojit të ngarkesës dhe shkallës së ndotjes. ECO ofron përdorimin më efikas të konsumit të ujit dhe të energjisë.

9.2 Përdorimi i kripës, shpëlarësit dhe detergjentit

- Përdorni vetëm kripë, shpëlarës dhe detergjent të projektuar për lavastovilje. Produktet e tjera mund të shkaktojnë dëmtimin e pajisjes.
- Në zonat me ujë të rëndë dhe shumë të rëndë ne rekomandojmë përdorimin e një detergjenti të thjeshtë për lavastovilje (pluhur, xhel, tableta pa agjentë shtesë), shpëlarësit dhe kripës veçmas për rezultate optimale pastrimi dhe tharjeje.
- Tabletat e detergjentit nuk shkrihen plotësisht në programet e shkurtra. Për të parandaluar mbetjet e detergjentit tek takëmet, ne ju rekomandojmë që t'i përdorni tabletat me programet e gjata.
- Mos përdorni më shumë se sasia e duhur e detergjentit. Referojuni udhëzimeve që jepen në paketimin e detergjentit.

9.3 Si të veproni nëse dëshironi të ndaloni përdorimin e tabletave të shumëfishta

Përpara se të filloni të përdorni veç e veç detergjentin, kripën dhe shkëlqyesin, kryeni hapat e mëposhtëm:

1. Vendosni nivelin më të lartë të zbutësit të ujit.
2. Sigurohuni që kutia e kripës dhe kutia e shkëlqyesit të jenë plot.
3. Nisni programin Quick. Mos shtoni detergjent dhe mos vendosni enë në kosha.
4. Kur programi të përfundojë, përshtateni zbutësin e ujit sipas fortësisë së ujit në zonën tuaj.
5. Rregulloni sasinë e lëshimit të shkëlqyesit.

9.4 Përpara fillimit të një programi

Përpara se të nisni programin e zgjedhur, sigurohuni që:

- Filtrat janë të pastër dhe të vendosur saktë.
- Kapaku i kutisë së kripës është i shtrënguar.
- Krahët spërkatës nuk janë të bllokuar.
- Ka kripë dhe shpëlarës të mjaftueshëm (përveç rastit kur përdorni tableta të shumëfishta).
- Pozicionimi i artikujve në kosha është i saktë.
- Programi mund të përdoret për llojin e ngarkesës dhe për shkallën e ndotjes.
- Është përdorur sasia e duhur e detergjentit.

9.5 Ngarkimi i koshave

- Përdoren pajisjen për të larë vetëm artikuj që mund të lahen në lavastovilje.
- Mos lani në pajisje artikuj prej druri, briiri, alumini, kallaji dhe bakri.
- Mos lani në pajisje artikuj që thithin ujë (sfungjerë, lecka pastrimi).
- Hiqni mbetjet e mëdha ushqimore nga enët.
- Njomini enët e gatimit me ushqim të djegur përpara se t'i lani në pajisje.
- Futini artikujt e thellë (filxhanët, gotat dhe tenxheret) me pjesën e hapur të drejtuar poshtë.
- Sigurohuni që gotat të mos prekin njëra-tjetrën.
- Vendosni artikujt e lehtë në koshin e sipërm. Sigurohuni që artikujt të mos lëvizin lirshëm.
- Vendosni takëmet dhe artikujt e vegjël në koshin e takëmeve.
- Sigurohuni që krahët spërkatës të jenë në gjendje të lëvizin lirshëm përpara se të nisni një program.

9.6 Zbrazja e koshave

1. Lërin enët të ftohen para se t'i hiqni ato nga pajisja. Enët e nxehta mund të dëmtohen lehtë.
2. Boshatisni koshin e poshtëm në fillim e më pas atë të sipërmin.



Pasi përfundon programi, uji mund të qëndrojë ende në sipërfaqen e brendshme të pajisjes.

10. KUJDESI DHE PASTRIMI



PARALAJMËRIM!

Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje përveç programit Machine Care, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza kryesore.



Filtrat e ndotur dhe krahët spërkatës të bllokuar ndikojnë negativisht në rezultatet e larjes. Kontrollonini këto elemente rregullisht dhe, nëse është e nevojshme, pastrojinini ato.

10.1 Machine Care

Machine Care është program i projektuar për të pastruar brendësinë e pajisjes me rezultate optimale. Ai heq akumulimin e çmërsit dhe yndyrës.

Kur pajisja dallon nevojën për pastrim, treguesi  ndizet. Nisni programin Machine Care për të pastruar brendësinë e pajisjes.

Nisja e programit Machine Care



Përpara se të nisni programin Machine Care, pastroni filtrat dhe krahët spërkatës.

1. Përdorni një heqës çmërsi ose produkt pastrues të projektuar posaçërisht për lavastoviljet. Ndiqni udhëzimet e shfaqura në paketim. Mos fusni enë brenda në kosha.
2. Shtypni dhe mbani shtypur njëkohësisht  dhe **AUTO** Sense për rreth 3 sekonda.

Treguesit  dhe  pulsojnë. Ekрани tregon kohëzgjatjen e programit.

3. Mbyllni derën e pajisjes për të filluar programin.

Kur programi përfundon, treguesi  fiket.

10.2 Pastrimi i brendshëm


- Pastroni me kujdes pajisjen me një leckë të butë e të njomë, duke përfshirë llastikun prej gome të derës.
- Mos përdorni produkte gërryese, sfungjerë pastrues gërryes, mjete të mprehta, lëndë kimike të forta, materiale pastruese të ashpra ose tretës.
- Për të ruajtur performancën e pajisjes suaj, përdorni një produkt specifik pastrimi për lavastoviljet të paktën një herë në dy muaj. Ndiqni me kujdes udhëzimet në paketimin e produktit.
- Për rezultate optimale larjeje, nisni programin Machine Care.

10.3 Pastrimi i jashtëm



- Pastrojeni pajisjen me një leckë të butë të lagësht.
- Përdorni vetëm detergjente neutrale.
- Mos përdorni produkte gërryese, materiale pastruese të ashpra ose tretës.

10.4 Pastrimi i filtrave


Sistemi i filtrave përbëhet nga 3 pjesë.




1. Rrotullojeni filtrin (B) në drejtim kundërorar dhe hiqeni.




2. Hiqeni filtrin (C) jashtë filtrit (B).
3. Hiqeni filtrin e sheshtë (A).




4. Lajini filtrat.



5. Sigurohuni që nuk ka mbetje ushqimesh ose dheu brenda ose përreth pjesëve anësore të dekantuesit.
6. Kthejeni filtrin e rrafshët në vend (A). Sigurohuni që të vendoset në mënyrë të saktë sipas 2 udhëzuesve.



7. Rimontoni filtrat (B) dhe (C).
8. Vendoseni përsëri filtrin (B) në filtrin e sheshtë (A). Rrotullojeni në drejtim orar derisa të ngecë.



KUJDES!


Pozicionimi i pasaktë i filtrave mund të sjellë rezultate të këqija larjeje dhe dëmtim të pajisjes.

10.5 Pastrimi i krahut të poshtëm spërkatës


Rekomandojmë të pastroni rregullisht krahun e poshtëm spërkatës për të shmangur bllokimin e vrimave nga ndotja.

Vrimat e bllokuara mund të sjellin rezultate të pakënaqshme larjeje.


1. Për të hequr krahun e poshtëm spërkatës, tërhiqeni atë lart.



2. Lajeni krahun spërkatës në ujë të rrjedhshëm. Përdorni një mjet të hollë me majë, p.sh. kruajtëse dhëmbësh, për të hequr mbetjet e ndotjes nga vrimat.



3. Për të instaluar sërish krahun spërkatës, shtypeni poshtë.



11. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE



PARALAJMËRIM!

Riparimi i pasaktë i pajisjes mund të sjellë rrezik për sigurinë e përdoruesit. Çdo riparim duhet kryer vetëm nga personeli i kualifikuar.

Referojuni tabelës së mëposhtme për informacion rreth problemeve të mundshme.

Për disa probleme, ekrani tregon kodin e alarmit.

Shumica e problemeve që mund të ndodhin mund të zgjidhen pa nevojën e një qendre të autorizuar shërbimi.

Problemi dhe kodi i alarmit	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
Nuk mund ta aktivizoni pajisjen.	• Sigurohuni që spina të jetë futur në prizë. • Sigurohuni që kutia e siguresave të mos ketë ndonjë siguresë të prishur.
Programi nuk fillon.	• Sigurohuni që dera e pajisjes të jetë e mbyllur. • Nëse është caktuar vonesa në nisje, anuloni cilësimin ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Pajisja rimbush rezinën brenda zbutësit të ujit. Kohëzgjatja e procedurës është afërsisht 5 minuta.
Pajisja nuk mbushet me ujë. Ekran shfaq 10 ose 11 .	• Sigurohuni që rubineti i ujit të jetë i hapur. • Sigurohuni që presioni i furnizimit me ujë të mos jetë shumë i ulët. Për këtë informacion, kontaktoni autoritetet vendase të ujësjellësit. • Sigurohuni që rubineti i ujit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që filtri në tubin hyrës të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që tubi i furnizimit me ujë të mos jetë i përdredhur ose i përthyer.

Problemi dhe kodi i alarmit	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
Pajisja nuk e shkarkon ujin. Ekran shfaq 20 .	• Sigurohuni që tubi lidhës i lavamanit të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që filtri në tubin dalës të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që sistemi i filtrit të brendshëm të mos jetë i bllokuar. • Sigurohuni që zorra e shkarkimit të mos jetë e përdredhur ose e përthyer.
Është aktivizuar pajisja kundër përmytjes. Ekran shfaq 30 .	• Mbylleni rubinetin dhe lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.
Pajisja ndalon dhe fillon shumë herë gjatë procesit.	• Kjo është normale. Kjo sjell rezultate optimale në larje dhe kursim energjie.
Programi zgjat shumë.	• Nëse është caktuar opsioni i vonesës në nisje, anuloni cilësimin e vonesës ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Aktivizimi i këtyre opsioneve mund të rrisë kohëzgjatjen e programit.
Koha e mbetur në ekran rritet dhe kapërcehet pranë fundit të kohëzgjatjes së programit.	• Ky nuk është defekt. Pajisja punon siç duhet.
Rrjedhje e vogël nga dera e pajisjes.	• Pajisja nuk është vendosur në nivel. Lironi ose shtrëngoni këmbët e rregullueshme (nëse ka). • Dera e pajisjes nuk është e centruar me kazanin. Rregulloni këmbët e pasme (nëse ka).
Dera e pajisjes mbyllet me vështirësi.	• Pajisja nuk është vendosur në nivel. Lironi ose shtrëngoni këmbët e rregullueshme (nëse ka). • Pjesë të takëmeve dalin jashtë nga koshat.
Zhurma kërcitëse ose goditëse nga brenda pajisjes.	• Takëmet nuk janë rregulluar mirë në kosha. Referojuni fletëpalosjes së mbushjes së koshave. • Sigurohuni që krahët spërkatës të rrotullohen lirshëm.
Bie automati nga pajisja.	• Amperazhi është i pamjaftueshëm për të furnizuar njëkohësisht të gjitha pajisjet në përdorim. Kontrolloni amperazhin e prizës dhe kapacitetin e matësit ose fikni një prej pajisjeve që jeni duke përdorur. • Defekt i brendshëm elektrik i pajisjes. Kontaktoni me një qendër të autorizuar shërbimi.

Pasi ta keni kontrolluar pajisjen, çaktivizojeni dhe aktivizojeni pajisjen. Nëse problemi ndodh përsëri, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

Për kodet e alarmit që nuk përshkruhen në tabelë, kontaktoni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

11.1 Rezultatet e larjes dhe të tharjes nuk janë të kënaqshme

Problemi	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
Rezultate të pakënaqshme larjeje.	- Referojuni kapitullit “Përdorimi i përditshëm”, “Udhëzime dhe këshilla” dhe fletëpalosjes për mbushjen e koshave. - Përdorni program me larje më intensive. - Aktivizoni opsionin ExtraPower për të përmirësuar rezultatet e larjes të programit të përzgjedhur. - Pastroni injektorët e krahëve spërkatës dhe filtrin. Referojuni kapitullit “Kujdesi dhe pastrimi”.
Rezultate të pakënaqshme tharjeje.	- Takëmet janë lënë shumë kohë brenda pajisjes së mbyllur. Aktivizoni AirDry për të vendosur hapjen e derës dhe për të përmirësuar performancën në tharje. - Nuk ka shkëlqyes ose dozimi i shkëlqyesit nuk është i mjaftueshëm. Mbusheni kutinë e shkëlqyesit ose vendoseni nivelin e shkëlqyesit në nivel më të lartë. - Shkaku mund të jetë cilësia e shkëlqyesit. - Rekomandojmë të përdorni gjithmonë shkëlqyes, edhe në kombinim me tableta të shumëfishta. - Artikujt plastikë mund të kenë nevojë të thahen me peshqir. - Programi nuk ka fazë tharjeje. Referojuni kapitullit “Vështrim i përgjithshëm i programeve”.
Ka vija të bardha ose shtresa me ngjyrë blu mbi gota dhe enë.	- Sasia e lëshuar e shkëlqyesit është tepër e madhe. Rregullojeni nivelin e shkëlqyesit në një nivel më të ulët. - Sasia e detergjentit është tepër e madhe.
Në gota dhe pjata ka njolla dhe pika të thata uji.	- Sasia e lëshuar e shkëlqyesit është e pamjaftueshme. Rregullojeni nivelin e shkëlqyesit në një nivel më të lartë. - Shkaku mund të jetë cilësia e shkëlqyesit.
Pjesa e brendshme e pajisjes është e lagur.	Ky nuk është defekt i pajisjes. Ajri i lagësht kondensohet në paretet e pajisjes.
Shkumë e pazakontë gjatë larjes.	- Përdorni detergjent të posaçëm për lavastovilje. - Ka rrjedhje në shpërndarësin e shkëlqyesit. Kontaktoni me një qendër të autorizuar shërbimi.
Ka gjurmë ndryshku në takëme.	- Në ujin e përdorur për larje ka shumë ujë. Referojuni kapitullit “Zbutësi i ujit”. - Janë vendosur bashkë takëme prej argjendi dhe inoksi. Mos vendosni së bashku artikuj prej argjendi dhe inoksi.

Problemi	Shkaku i mundshëm dhe zgjidhja
Ka mbetje detergjenti në shpërndarës në fund të programit.	• Tableta e detergjentit ka ngecur në shpërndarës dhe për këtë arsye nuk është larë krejtësisht nga uji. • Uji nuk mund të lajë detergjentin nga shpërndarësi. Sigurohuni që krahët spërkatës të mos jenë bllokuar. • Sigurohuni që artikujt në kosha të mos pengojnë hapjen e kapakut të shpërndarësit të detergjentit.
Pajisja mban erë të keqe brenda.	• Referojuni kapitullit “Pastrimi i brendshëm”. • Nisni programin Machine Care me një heqës çmërsi ose produkt pastrues të projektuar për lavastovilje.
Depozitime çmërsi në takëme, në kazan dhe në anën e brendshme të derës.	• Niveli i kripës është i ulët, kontrolloni treguesin e rimbushjes. • Kapaku i kutisë së kripës është i lirë. • Uji i rubinetit është i fortë. Referojuni kapitullit “Zbutësi i ujit”. • Përdorni kripë dhe vendosni rigjenerimin e zbutësit të ujit edhe kur përdoren tableta multi-funksionale. Referojuni kapitullit “Zbutësi i ujit”. • Nisni programin Machine Care me një heqës çmërsi të projektuar për lavastovilje. • Nëse vazhdon të mbeten depozita çmërsi, pastrojeni pajisjen me pastrues që janë të përshtatshëm për këtë qëllim. • Provoni detergjent tjetër. • Kontaktoni me prodhuesin e detergjentit.
Takëme të turbullta, të çngjyrosura ose të ciflosura.	• Sigurohuni që në pajisje të lahen vetëm artikujt që mund të lahen në lavastovilje. • Ngarkoni dhe shkarkoni koshin me kujdes. Referojuni fletëpalosjes së mbushjes së koshave. • Vendosni artikujt delikatë në koshin e sipërm. • Aktivizoni opsionin GlassCare për të siguruar kujdes special për artikujt delikatë dhe qelqerinat.



Referojuni kapitujve **“Përpara përdorimit”**, **“Përdorimi i përditshëm”** ose **“Udhëzime dhe këshilla”** për shkaqet e tjera të mundshme.

12. FLETA E INFORMACIONIT TË PRODUKTIT

Marka tregtare	Electrolux
Modeli	EES47310L 911536425

Kapaciteti nominal (cilësimet standarde të vendit)	13
Klasi i efikasitetit të energjisë	A+++
Konsumi i energjisë në kWh në vit, bazuar në 280 cikle standarde pastrimi duke përdorur ujë të ftohtë dhe konsumin e regjimeve me fuqi të ulët. Konsumi aktual i energjisë do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes.	234
Konsumi i energjisë i ciklit standard të pastrimit (kWh)	0.821
Konsumi i energjisë në regjimin fikur (W)	0.50
Konsumi i energjisë në regjimin e lënë ndezur (W)	5.0
Konsumi i ujit në litra në vit, bazuar në 280 cikle standarde pastrimi. Konsumi aktual i ujit do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes	2772
Klasi i efikasitetit të tharjes në një shkallë nga G (më pak efikase) në A (më efikase)	A
“Programi standard” është cikli standard i pastrimit me të cilin lidhet informacioni në etiketë dhe në fletë. Ky program është i përshtatshëm për të pastruar takëmet e tavolinës me ndotje normale dhe është programi më efikas për sa i përket konsumit të kombinuar të energjisë dhe ujit. Ai emërtohet si programi “Eco”.	ECO
Koha e programit të ciklit standard të pastrimit (min)	240
Kohëzgjatja e regjimit të lënë ndezur (min)	1
Nivelet e fuqisë së zhurmës (dB(A) re 1pW)	46
Pajisje inkaso Po/Jo	Po

13. INFORMACIONET TEKNIKE SHITESË

Përmasat	Gjerësia / lartësia / thellësia (mm)	596 / 818 - 898 / 550
Lidhja elektrike ¹⁾	Tensioni (V)	220 - 240
	Frekuenca (Hz)	50
Presioni i furnizimit me ujë	Min. / Maks. bar (MPa)	0.5 (0.05) / 8 (0.8)
Furnizimi me ujë	Ujë i ftohtë ose ujë i ngrohtë ²⁾	maks. 60°C

¹⁾ Referojuni pllakës së klasifikimit për vlerat e tjera.

²⁾ Nëse uji i ngrohtë vjen nga burim alternativ energjie (p.sh. panele diellore), përdorni furnizimin me ujë të nxehtë për të ulur konsumin e energjisë.

14. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN

Ricikloni materialet me simbolin .
Vendoseni ambalazhin te kontejnerët e riciklimit nëse ka. Ndihmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni

pajisjet e shënuara me simbolin  e mbeturinave shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

www.electrolux.com/shop



156932860-A-292019

